



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 561/2 prot.,

Datë 15.03.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR  
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albavia” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-46203-10-17-2022, me objekt: “*Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë*” me fond limit 220 320 000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

**Ankimues:** “Albavia” SHPK.  
*Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk.1, ap.19, Tiranw*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Pogradec  
*Lagja nr 2, bulevardi "Reshit Çollaku", Pogradec*

Në datën 15.03.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 561 protokolli e operatorit ekonomik “Albavia” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-46203-10-17-2022, me objekt: “*Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë*” me fond limit 220 320 000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Albavia” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Albavia” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr 561 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

*1- Nga Operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk, me Nipt J81527001Q, nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, siç kërkohen në DST. Konkretisht, Ne Piken 2.3.9 Te DST: 1 Mjeti me numer shasie 6498 Volvo L120, I deklaruar si skreper nga operatori ekonomik ne Formularin e Vetedeklarimit, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nuk rezulton te jete Skreper por Fadrome e perdorur. 2- Per Kamioncinen me targe TR5481P, nuk ka paraqitur certificate pronesie. 3- Per Kamioncinen me targe TR5569P, nuk ka paraqitur certificate pronesie. 4- Per Fabriken e Asfaltobetonit S/N 1872, nuk ka paraqitur asnje dokument. Për sa më sipër, oferta e OE-së “ALBAVIA” shpk, rezulton e pavlefshme.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 15.03.2023.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**